

KALLËZIM PENAL

KALLZUES: PARTIA DEMOKRATIKE DEGA DIVJAKË

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale , Neni 248 “Shpërdorimi detyrës”
 ,Neni 328/a “Detyrimi për pjesmarrje në veprimtari
 politike”,Neni 250 “ Kryerja e veprimeve arbitrare”.

KUNDER:

DREJTUAR: PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË LUSHNJË

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280 dhe 283, si dhe neneve 248, 250, dhe 328/a të Kodit Penal, parashtrorjmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 parashikon se:

Neni 280

Marrja dijëni për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dijëni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.

Neni 283

Kallëzimi nga ana e shtetasve

Çdo person që ka marrë dijëni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.